

SHQYRTIMI I PËRVOJAVE DHE I PRAKTIKAVE NGA KËSHILLAT NDËRKOMBËTARË PËR ETIKË NË MEDIA



**SHQYRTIMI I PËRVOJAVE DHE I PRAKTIKAVE
NGA KËSHILLAT NDËRKOMBËTARË PËR ETIKË NË MEDIA**

Mars 2017

Botues:

Këshilli për Etikë në Mediat e Maqedonisë
Bul. Teodosij Golloganov 54-2, Shkup, Maqedoni
www.semm.mk

Autor:

prof. dr. Dejan Donev

Koordinimi:

dr. Marina Tuneva

Lektor:

Ruzhica Pejoviq

Dizajni:

Myprint

Shtyp:

Myprint

Tirazh:

30

Përgatitja e këtij botimi u mundësua me mbështetjen e projektit „#ReforMedia – Avancimi i bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile, institucioneve dhe qytetarëve për zbatimin e reformave në sferën mediatike“ të cilin e zbatojnë Instituti Maqedonas për Media dhe Instituti Paqësor nga Lubjana. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e plotë e autorit dhe e Këshillit për Etikë në Media dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron qëndrimet e BE-së.

PËRMBAJTJA

Hyrje	5
I. Shqyrtim i përvojave dhe i praktikave të këshillave për etikë në rrjetin e Aleancës për këshilla të pavarur për etikë në Evropë (AIPCE)	7
II. Shqyrtim i përvojave dhe i praktikave në raportimin mbi çështjet sensitive me interes publik	13
III. Përfundim	19
IV. Literatura e përdorur	20

HYRJE

Në kushtet e sotme, duke u ballafaquar me dilemat e vjetra por edhe me të reja, gazetarët dhe punonjësit mediatik në përgjithësi duhet të jenë koizistentë gjatë zbatimit të standardeve etike dhe profesionale, në veçanti në mjedisin që është nën ndikimin revolucionar të teknologjive të reja. Një nga mënyrat është përmes përdorimit të vetë-rregullimit, i cili ka ndikim të drejtpërdrejt mbi lirinë e informimit: „mediat janë një mekanizëm i shkëlqyer me anë të të cilit qytetarët kërkojnë përgjegjësi ndaj opinionit dhe individëve. Megjithatë, mediat duhet që edhe vetë të jenë të përgjegjshëm nëse dëshirojnë ta mbajnë rolin e rojtarit në raport me pushtetin dhe pushtetarët tjerë, dhe mu vetë-rregullimi paraqet atë funksion dhe rol qendror, duke e nxitur në të njëjtën kohë edhe përgjegjësinë mediatike ndaj publikut dhe duke e përforcuar cilësinë e medias përmes mekanizmave vullnetarë, të cilët profesionistët mediatik i ndjekin“¹.

Kur flasim për vetë-rregullimin dhe për formën paraqitëse të tij, në fakt, bëhet fjalë për „pjesëmarrjen e gazetarëve, pronarëve të mediave dhe përfaqësuesve të opinionit në përcaktimin e aplikimit të parimeve etike në media“² përmes formave të ndryshme të organeve vetë-rregulluese, nga këshilla për media dhe ombudsmanë për media, deri në kombinimin e të dyjave, varësisht nga tradita e vendeve të caktuara. Në ndërkohë, me rëndësi të veçantë është ekzistimi i këshillit për etikë, si „prototip i trupit vetë-rregullues dhe, kryesisht, si forma më e shpeshtë e një organi vetë-rregullues“³.

Edhe realiteti mediatik në Republikën e Maqedonisë shënon ekzistimin dhe funksionimin e suksesshëm të Këshillit për etikë në media nga dhjetori i vitit 2013. Si rezultat i përvojave të deri tanishme nga zbatimi i vetë-rregullimit, tek ne dhe më gjërë, konfirmohet se zbatimi i tij është një sfidë e vërtetë. Duke pasur parasysh që edhe temat dhe përvojat nga shtetet tjera që kanë traditë më të gjatë të vetë-rregullimit mediatik janë të pashmangshme, ideja për këtë shqyrtim është që të sigurohet prezantim narativ i përvojave dhe praktikave në ballafaqimin me çështje të caktuara nga ana e këshillave për etikë - anëtare të Alencës për këshilla të pavarur për etikë në media në Evropë (AIPCE)⁴ në disa segmente, por, edhe të

1 Janis Karklinsh, „Uvodnik“, në *Profesionalno novinarstvo & Samoregulacija*, Stjepan Malović (ur.), UNESCO, Zagreb, 2001, f. 11.

2 Gordana Villović, „Etičnost masovnog komuniciranja“, në *Masovno komuniciranje*, Stjepan Malović et al. (ur.), Golden marketing-Tehnička knjiga, Sveučilište Sjever, Zagreb, 2014, f. 268.

3 Ognjan Zlatev, „Совет за етика“, në *Водич за саморегулација во медиумите*, Miklosh Harashti dhe të tjerë, Këshilli për etikë në media në Maqedoni, Shkup, 2016, f. 45-46.

4 Bëhet fjalë për një „rjet joformal“ të themeluar në vitin 1999 në Londër, i cili deri në këtë moment

kodekseve etike, me fokus mbi dispozitat e tyre që kanë të bëjnë me raportimin mbi çështje të caktuara, sensitive, siç janë: *mbrojtja e personaletit dhe privatësisë, parandalimi i diskriminimit në baza të ndryshme, mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve, raportimi mbi krime, vetëvrasje, etj.*

Ideja doli si rezultat i praktikës së deritanishme të komunikimit të rregullt dhe të dobishëm mes Këshillit për etikë në mediat e Republikës së Maqedonisë dhe anëtarëve të Aleancës. Në të njëjtën kohë, rezultatet e atij diskutimi janë të dobishme jo vetëm për Këshillin, por, edhe për opinionin e ekspertëve dhe më gjërë, e cila duhet për së afërmi të njihet me punën, qasjen dhe përfitimet e ekzistimit dhe funksionimit të organit vetë-rregullues. Në të njëjtën kohën, bashkëpunimi me anëtarët mundësoon që Këshilli për etikë në media në Republikën e Maqedoninsë, vazhdimisht dhe hapur të diskutojë dhe të shkëmbejë përvoja për dilemat ekzistuese dhe potenciale si dhe për zgjidhjen e tyre, por, edhe të njoftohet me çështjet e reja dhe sifdat në sferën mediatike, të cilat i nënshtrohen vrojtimit etik, shqyrtimit dhe zgjidhjes.

Metodologjia që përdorej gjatë përgatitjes së këtij Shqyrtimi përfshin analizë të dokumenteve, kornizave etike, rregullativave, opinioneve dhe vendimeve, analizave të të dhënave sekondare, por edhe të burimeve të tjera shtesë që kanë të bëjnë me temën e hulumtimit. Pjesa e parë e Shqyrtimit rezulton nga shqyrtimi i qasjes në punën e këshillave për etikë, në pjesën e dilemave të parashtruara praktike dhe zgjidhjen e tyre, të cilat janë me rëndësi thelbësore për punën e këshillave për etikë, sidomos për të sapo formuarit, ndërsa pjesa e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e elementeve të caktuara nga kodekset e përzgjedhura që ju përgjigjen sfidave me të cilat ballafaqohen gjatë raportimit mediatik mbi çështje sensitive me interes publik. Mes tjerash, qëllimi është që të kuptohet se sa ato e pasqyrojnë realitetin në veprimtarinë e mediave tradicionale dhe sociale, dhe mediave të reja nga perspektiva e sotme.

ka bashkuar rreth 40 këshilla evropian të pavarur për etikë, me qëllim që përmes takimeve vjetore të sigurojë forum për diskutim mbi temat aktuale, si dhe shkëmbim të ideve, informacioneve të dobishme por, edhe këshillave për dilema të caktuara ndërmjet përfaqësuesve të anëtarëve të tij. Edhe pse fokusi është në terrenin evropian mediatik, në rrjetin e saj, Aleanca përfshin edhe organe vetë-rregulluese nga vende të tjera të botës.

I. SHQYRTIMI I PËRVOJAVE DHE PRAKTIKAVE TË KËSHILLIT PËR ETIKË NË RREJTIN E ALEANCËS PËR KËSHILLAT E PAVARUR PËR ETIKË NË EVROPË (AIPCE)

Nga korpusi i materialit të përpunuar voluminoz, i cili është rezultat i komunikimit intenziv dhe bashkëpunimit me anëtarët e Aleancës, fokusi qëndron në ato çështje dhe dilema që janë në korelacion të ngushtë me punën e Këshillit për etikë në media në Republikën e Maqedonisë, dhe të cilat nga shumë aspekte do të mund të merreshin si bazë solide për zgjidhjen e dilemave të caktuara në punën e tij. Në të njëjtën kohë, ato do të ishin të dobishme edhe për ekspertët, por, edhe për opinionin më të gjërë i cili dëshiron të njihet me mënyrën e ekzistimit dhe të funksionimit të këshillave si organe vetë-rregulluese.

Rrjedhimisht, pjesa më e madhe e analizës ka të bëjë me *të drejtat, deyrat dhe mënyrat e funksionimit të këshillave*, në të cilat përfshihen këto çështje dhe dilema:

1. Për kriteret për anëtarësim në Këshill, rregullimin e sistemit të votimit, si dhe për të drejtën e votës të anëtarëve të Këshillit:

Në Belgjikë ekzistojnë veças Bordi dhe Këshilli për etikë. I pari është i përbërë në mënyrë të barabartë nga përfaqësues të asociacioneve të botuesve, mediave radiodifuzive dhe agjencive gazetareske por, edhe nga asociacionet e gazetarëve, ndërsa i dyti, është i përbërë në mënyrë të barabartë nga përfaqësues të botuesve, mediave radiodifuzive dhe agjencive gazetareske, më tej nga asociacionet e gazetarëve, por edhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile. Përderisa Bordi është ai i cili e pranon kodeksin dhe ndryshimet në të, emërton anëtarë të Këshillit për etikë, si dhe sekretar gjeneral /avokat të popullit dhe asistent administrativ, Këshilli është ai që e bën përgatitjen e ndryshimeve të kodeksit, përgatitjen dhe miratimin e udhëzimeve të reja dhe menaxhimin e ankesave. Bëhet fjalë për një sistem i cili është pothuajse i njëjtë edhe për Këshillin në Belgjikë, në pjesën frankofone, me çka ndryshimi i vetëm është se ky Këshill i ka dy anëtarë shtesë në Këshillin për etikë, gjegjësisht, dy përfaqësues nga redaktorët.

Zgjidhje të ndryshme nga ajo e mëparshmeja hasim në Zvicër, ku në Këshill nuk ka anëtarësi, por është i themeluar dhe i financuar nga unionet e gazetarëve, asociacionet botuese, asociacioni i redaktorëve, si dhe nga radiodifuzerët publik, me çka, Këshilli themelues emërton anëtarë të Këshillit për etikë.

Në Norvegji, Këshilli për etikë⁵ është i formuar në vitin 1929 nga ana e asociacionit mediatik të norvegjisë, si organ profesional ku shumicën e përbëjnë punonjësit mediatik dhe i cili gjithmonë udhëhiqet nga një redaktor apo gazetar. Qëllimi i tij kryesor është mbikqyrja dhe avancimi i standardeve profesionale dhe etike në të gjitha mediat në Norvegji. Ai është i përbërë sipas propozimit të asociacionit mediatik norvegjez, nga përfaqësues me mandat dyvjeçar me nga dy redaktorë dhe gazetarë si dhe tre përfaqësues të shumë respektuar nga publiku, ndërsa udhëhiqet nga Kodeksi Etik, si dhe nga Kodeksi i redaktorëve, i miratuar në vitin 1953.

Nga rajoni, Këshilli për etikë i BeH është themeluar nga 10 mediat më të mëdha të shkruara dhe dy asociacione të gazetarëve të BeH. Të gjitha mediat e shkruara dhe onlajn mund të jenë anëtarë zyrtar nëse mediat janë të regjistruara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, gjegjësisht si persona juridik në lëminë e gazetarisë dhe industrisë së mediave, por, jo edhe si shoqëri qytetarësh apo kompani marketingu. Bordi i drejtorëve vendos për pranimin e anëtarëve të ri, ndërsa Kuvendi e vërteton këtë vendim. Një numër i caktuar i mediave kanë dy, tre apo vetëm një përfaqësues në Kuvendin e Këshillit për etikë, por, kur bëhet fjalë për votim, vetëm nga një përfaqësues i medias ka të drejtë vote, me çka vendimet miratohen me shumicën e votave.

Në terma më të gjerë, në Republikën e Afrikës së Jugut, për shembull, 50% e Këshillit për etikë është i përbërë nga përfaqësues të opinionit, ndërsa 50% nga përfaqësues të komunitetit të gazetarëve. Komisioni për ankesa nga mediat elektronike është i përbërë nga një kryetar, i cili është i emëruar nga vet Komisioni, ndërsa 12 anëtarë janë të emëruar nga një gjykatës i pensionuar, të cilin njëkohësisht e përcakton ombudsmani. Në Azerbejxhan, Bordi është organ drejtues i Këshillit për etikë, i cili është i përbërë më së shumti nga përfaqësues të mas-mediave tradicionale, më pas, nga anëtarë që e përfaqësojnë interesin publik, por, edhe nga anëtarë të portaleve të internetit. I njëjti Këshill ka rreth 200 organizata anëtare, e që përfshijnë: gazetatat, agjencitë informative, resurset e infomacioneve-internetit dhe organizatat mediatike. Sapo të kalojë mandati katë vjeçar i Bordit, thirret kongresi i ri, në të cilin duhet të zgjedhen anëtarë të ri të Bordit.

5 Model sipas të cilit u formua Këshilli për etikë në media, në Maqedoni.

2. Për respektimin/marrjen parasysh të vendimeve të Këshillit për etikë në proceset gjyqësore, por, edhe për koordinimin e mundshëm të Këshillit dhe trupit rregullator për çështje të caktuara:

Ekzistojnë zgjidhje të ndryshme në lidhje me këtë çështje. Gjegjesisht, në Zvicër, jo rrallë gjykata (madje edhe ajo Federale) thirret në vendime dhe konsiderata etike të Këshillit për etikë në media. Edhe pse nuk ekziston një koordinim specifik, ka raste kur Këshilli për etikë fton një gjykatës nga gjykata Federale, në mbledhje të Këshillit me qëllim përgatitjen e një vendimi në lidhje me raportimin mbi proceset gjyqësore.

Në Belgjikë, me qëllim që të zgjidhet një rast që ka të bëjë me gazetarë apo media, një ndër kriteret që e përdorin gjykatësit në punën e tyre gjatë vendimmarrjes, është marrja parasysh e rregullave etike të gazetarisë. Nga këtu, edhe misioni i Këshillit si organ vetë-rregullues është sigurimi i këshillave të gjykatësve apo gjykatave kur ata e kërkojnë këtë nga Këshilli. Në këtë kontekst, mund të flitet edhe për bashkëpunim institucional, i cili edhe pse nuk ekziston si një mekanizëm zyrtar, por, më shumë si një formë e praktikës joformale, megjithatë kur bëhet fjalë, për shembull, për raste të gjuhës së urrejtjes nga ana e gazetarëve, Këshilli zakonisht e informon Qendrën e cila është e krijuar nga ana e autoriteteve kompetente për të vepruar në lidhje me rastet që kanë të bëjnë me racizëm, diskriminim, gjuhë të urrejtjes..., ndërsa Qendra vendos se çfarë do të bëjë më tej më këto informacione.

Praktika e këtyre është e evidente në rajonin flaman të Belgjikës, ku është vërejtur bashkëpunim mes Këshillit dhe Qendrës për mundësi të barabarta, si institucion publik i cili lufton diskriminimin në bazë ligjore.

Në bazë të këtyre praktikave, është interesante edhe përvoja e Irlandës, ku në bazë të ligjit për shpifje nga viti 2009, gjegjesisht neni 26, gazeta që është e paditur mund që në mbrojtje të saj të thirret në faktin që ka punuar në pajtueshmëri me Kodeksin e Këshillit për media dhe vendimet e tij.

3. Për rregullativat dhe mundësinë e zhvillimit të procedurave paralele në Këshill dhe në gjykatë:

Në Irlandë, Këshilli nuk i shqyrton ankesat në rast se është inicuar procedura gjyqësore, dhe kjo pa marr parasysh nëse procedura ka filluar para paraqitjes së ankesës deri te Këshilli apo gjatë kohës së shqyrtimit të saj. Pikërisht, shqyrtimi i ankesës në Këshill shtyhet deri në përfundimin apo ndalimin e procedurës gjyqësore, me kusht që të gjitha procedurat apo ndërprerjet të jenë në kohëzgjatje prej dy vitesh nga dita e publikimit të artikullit. Pas kësaj periudhe çështja mbyllet. Në të njëjtën kohë, mundësia e ndonjë iniciimi eventual të ndonjë procesi gjyqësor

vetvetiu nuk është e mjaftushme që të shtyhet shqyrtimi i ankesës. Megjithatë, nëse gjatë pranimit të ankesës është dhënë njoftim për inicim eventual të procesit gjyqësor nga ana e ankuesit, nga ai kërkohet vërtetim se nuk do të inicohen kurrfarë procese gjyqësore përderisa nuk përfundon shqyrtimi i ankesës nga ana e Këshillit. Përveç kësaj, nëse artikulli me të cilin ka të bëjë ankesa është raport për procedura gjyqësore, nga ankuesi kërkohet, aty ku akoma nuk është e qartë, të specifikojë nëse janë të kompletuara të gjitha procedurat gjyqësore për lëndën.

Bëhet fjalë për një mekanizëm shumë të ngjashëm me atë të Australisë, ku prej ankuesve nuk kërkohet që të heqin dorë nga çfarëdo procesi gjyqësor, por, prej tyre pritet që të deklarohen se nuk mendojnë për procese gjyqësore eventuale në momentin kur dorëzohet ankesa. Nga këtu, nëse Këshilli konstaton se paralelisht është në rrjedhë edhe procedura civile edhe ajo gjyqësore, pezullohet shqyrtimi i ankesës derisa nuk kryhen procedurat. Edhe në Zvicër, rregullativa e Këshillit Zvicerian për etikë në media nuk lejon pranimin e ankesave nëse në rrjedhë është apo parashikohet një proces paralel. Megjithatë, nëse bëhet fjalë për një problem esencial të etikës profesionale, Këshilli Zvicerian mund ta shqyrtojë rastin.

Përvoja në Finlandë tregon se nëse ankuesi kërkon vendim sipas të cilit do të mund të ndërmerr veprime në gjykatë për procedim penal apo për dëmshpërblim, ekziston baza për refuzimin e ankesës. Në rast të këtillë, Këshilli nuk e shqyrton apo e ndërpret shqyrtimin e ankesës. Në linjë me një praktikë të këtillë, sistem më rigoroz mund të haset në Estoni, ku në përputhje me Statutin e Këshillit të atjeshëm, përveç se ankesat nuk mund paralelisht të shkojnë para Këshillit dhe para gjykatës, Këshilli për media nuk i shqyrton edhe nëse ankuesi nuk identifikohet dhe nëse ankesa nuk ka të bëjë me shkeljen e praktikave të mira gazetareske. Aq më tepër, në Azerbejxhan, Këshilli për etikë i hedh poshtë rastet kur ankesa veç më është e shqyrtuar në gjykatë apo është nën hetim të shërbimeve të sigurisë.

Holanda, Norvegjia dhe Suedia ka përvoja tërësisht të ndryshme nga përvojat e mëparshme ku Këshilli për etikë nuk ka një sistem për ndërprerjen e procedurës. Ankuesit janë të lirë që të shkojnë në gjykatë dhe/apo para Këshillit për etikë, madje edhe në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh se rregullat ligjore dhe etike nuk janë gjithmonë të njëjta. Mund të ekzistojë shkelje e dispozitës etike, por, përsëri të respektohet ligji dhe e kundërta, aq më tepër që Këshilli nuk mund të urdhërojë sanksione, ndërsa gjykata e ka atë mundësi. Në këtë kontekst, nëse ankuesi deklaron se gazetari ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, Këshilli në mënyrë eksplicite, në vendimin e tij përcakton se si organ vetë-rregullues, nuk është kompetent për të sjellur vendim në lidhje me atë.

4. Për mënyrën e shqyrtimit dhe vendimmarjes lidhur me ankesat;

Në nivel rajonal, në Këshillin Kosovar për etikë, votimi dhe vendimarrja bëhet me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë. Në Komisionin për ankesa të BeH nuk votohet, por rastet diskutohen, ndërsa anëtarët duhet të jenë konsensual rreth vendimit, i cili duhet të jetë i miratuar njëzëri. Në Serbi, nëse nuk mund të arrihet një konsensus, do të deklarohen se nuk mund të pajtohen në lidhje me vendimin dhe do t'i sqarojnë arsyet e mospajtimit.

Analizuar më gjërë, në Spanjë, edhe pse rrallë, megjithatë, Këshilli katalonas për informacione mundohet që ankesës t'i afrohet nga pozicione të ndryshme dhe të arrijë një marrëveshje të përgjithshme. Edhe në Këshillin estonez për etikë, së pari kërkohet konsensus, ndërsa votimi është mundësi e fundit, e cila rrallë përdoret. Në këtë linjë të praktikës është edhe Këshilli belg për etikë, i cili që nga themelimi në vitin 2002 deri më tani, të gjitha vendimet i merr me konsensus, edhe pse nuk përjashtohen edhe opsionet tjera. Kështu është edhe në Holandë, ku në të shumtën e rasteve deri më tani, vendimet i sjellin me anë të konsensusit. Megjithatë, nëse është e nevojshme, në pajtueshmëri me rregullativat e Këshillit për etikë, vendoset me shumicën e votave, me çka nuk ekziston „sistem i mendimeve të ndara“. Një praktikë e këtillë ekziston edhe në Australi, si dhe në Qipro, ku, Komisioni për ankesa vendos me konsensus, por, teknikisht të mjaftueshme janë shumica e votave. Në Austri, anëtarët e Senatit të tyre, madje nuk kanë mundësi për t'u përmbytur, njëjtë si në Këshillin norvegjez për etikë në media.

Në Finlandë, në rast të mungesës së konsensusit, vendimet e Këshillit merren me anë të votimit të hapur. Nëse rezultatet nga votimi janë të ngushta, kryetari e ka votën vendimarrëse. Në Zelandën e Re ata që nuk pajtohen me vendimin, kanë mundësinë që mospajtimi i tyre të shënohet, edhe atë thekshtë duke i shënuar emrat e atyre që nuk janë pajtuar, e deri te nënvizimi i disa detajeve të caktuara rreth arsyes së mospajtimit.

Zgjidhje interesante vërehen në Irlandë, ku vendimin e parë e sjell ombudsmani për media. Edhe ankuesi edhe botuesi, më pas, në baza të kufizuara, mund të ankohen rreth vendimit të ombudsmanit për media në Këshill, i cili kërkon konsensus, ndërsa, nëse nuk e arrin, vendimi merret me anë të shumicës së votave. Në këtë kontekst, është interesant edhe zgjidhja në Suedi, ku Këshilli i atjeshëm për etikë i ka 8 vota – 4 prej tyre të përfaqësuesve të mediave, 3 të përfaqësuesve nga publiku dhe një nga gjykatësi i Gjykatës së lartë në Suedi. Nëse votimi përfundon me rezultat 4-4, gjykatësi e ka votën vendimarrëse.

5. Për vendimet që kanë të bëjnë me ankesat lidhur me materialet onlajn, shërbimet dhe gazetarinë, por edhe në lidhje me blogjet që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me mediat tradicionale:

Lidhur me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe dilemës së madhe: vallë a mund që blogjet, forumet e internetit si dhe Fejsbuk, të konsiderohen si gazetar? Në zvicër, Këshilli për etikë nuk shqyrton përmabjtjet e blogjeve, forumeve dhe përmabjtjeve në Fejsbuk, dhe sipas kësaj, nuk sjell vendime në lidhje me ta, por, në Zelandë të Re, Këshilli për etikë e ka zgjeruar fushën e tij të veprimit dhe i shqyrton edhe përmabjtjet e blogjeve. Në këtë kontekst, më larg ka arritur Norvegjia, ku edhe Kodeksi për etikë edhe sistemi për ankesa janë të hapur për blogerët dhe botuesit e pavarur⁶.

Në anën tjetër, në Belgjikë, Këshilli për etikë i pranon ankesat që kanë të bëjnë me blogjet dhe postimet nëpër media sociale, por, vetëm të atyre që u përkasin gazetarëve. Këtë e bën vetëm me kusht që gazetari të veprojë si gazetar dhe blogu apo postimi të jetë produkt gazetaresk, që do të thotë se Këshilli nuk merret me postime personale.

Komisioni Qipriot për ankesa, pranon ankesa edhe për blogerë, me atë se edhe atëherë kur blogeri nuk është gazetar, Komisioni pranon ankesa në rast se blogu përhap informata. Me këtë rast, Komisioni insiston që të gjitha ueb-faqet e mediave, përfshirë këtu edhe blogjet, ta respektojnë detyrimin për t'i moderuar komentet nga opinionioni dhe t'i fshijnë ato që janë vulgare, të papërshtatshme apo që në çfarë do mënyre shkelin të drejtat e tjetrit.

Lidhur me ankesat që vijnë për blogjet që nuk janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejt me mediat tradicionale, në Norvegji, si dhe në Finlandë, deri te këshillet për etikë paraqiten ankesa të këtilla, si për reklamim të fshehur, ashtu edhe për fyerje të ndonjë personaliteti nga ana e blogerit. Edhe ombudsmani për media në Suedi deri më tani ka pranuar ankesa në lidhje me profile në Twitter, edhe pse i ka hedhur poshtë.

Mu për këtë, në Holandë, për shembull, bëhet dallimi mes asaj se çfarë është vendimtare, a mund që një blog të konsiderohet si „akt gazetaresk“ apo lëshim në realizimin e profesionit të gazetarit të blogerit. Nga këtu, ky Këshill bën dallime mes asaj që është sjellje gazetareske dhe asaj që nuk është. Në këtë kontekst, në Suedi, mundet të bëhen ankesa rreth asaj që është e shkruar në profilet e mediave sociale, por, vetëm nëse ata janë të lidhura me median, me ç'rast termi „të lidhur“ nënkupton ekzistencën e profileve që hapen në emër të medias dhe të cilat kontrollohen nga ana e redaktorit përgjegjës.

Qasje e ngjashme vërehet edhe në Australi. Juridiksioni i Këshillit për etikë iu referohet edhe ankesave për gazeta, revista, media onlajn, që meren me lajme

6 Për to së pari parashikohet tarifë vjetore prej 800 euro, për pjesëmarrje në Këshillin për Etikë.

dhe botime digjitale të lidhura me to, si Fejsbuku, Tuiteri, deri atëherë kur botuesi i kontrollon faqet relevante, në kuptimin e faqes së tyre të Fejsbukut apo postimit... Edhe në Irlandë Këshilli për etikë pranon ankesa për materialet e publikuara në blogje me kusht që blogeri të identifikohet si anëtar i edicionit.

II. SHQYRTIMI I PËRVOJAVE DHE I PRAKTIKAVE PËR RAPORTIMIN MBI ÇËSHTJE SENSITIVE ME INTERES PUBLIK

Në botën e sotme të mediave, në kushte të rritjes së numrit të aktorëve të cilët marrin pjesë në prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit, në shfaqjen e metodave të reja të prodhimit dhe shpërndarjes së informatave, si dhe shpejtësisë së paparë deri tani të plasimit të prodhimeve mediatike, sfida është sigurimi i zbatimit të standardeve të vetë-rregullimit gjatë raportimit, në veçanti përmes mediave onlajn.

Mu kjo sfidë, mënyrat se si zbatohen standardet e vetë-rregullimit, është ideja për pjesën e dytë të shqyrtimit. Ai ofron analizë të elementeve nga kodekset etike të një pjese të anëtarëve të AIPCE, të cilët japin përgjigje (të mundshme) për sfidat, me të cilat ballafaqohemi gjatë raportimit mbi çështje sensitive me interes publik. Bëhet fjalë për shqyrtim dhe analizë të vetëm një numri të caktuar kodeksesh, të cilët për arsye të qartësisë normative dhe aplikative, respektivisht, dispozitave eksplicite në trajtimin e çështjeve, temave dhe sfidave sensitive, mund që njëkohësisht të jenë të dobishme edhe përgjatë plotësisë eventuale të kornizës etike në Republikën e Maqedonisë, kur bëhet fjalë për këto tema, me qëllim të rritjes së vetëdijes mbi vlerën e vërtetë dhe zbatimin e vetë-rregullimit.

1. *Mbrojta e individit dhe privatësisë gjatë raportimit*

Me paraqitjen dhe rritjen e numrit të mediave të reja, por edhe të realitetit dukshëm të deformuar mediatik, çështjet rreth mbrojtjes së individit dhe privatësisë u ngriten si çështje nominale „të nxehta“ në punën e këshillave për etikë. Në pajtueshmëri me dispozitat e analizuara të Kodeksit qipriot etik⁷, në bazë të të cilit vepron Komisioni qipriot për ankesa pranë Këshillit për etikë, jo vetëm që ua ndalon mediave dhe gazetarëve ta sulmojnë individin dhe të përdorin fjalë fyese të cilat e rrënojnë nderin dhe reputacionin e individëve, por, thuhet edhe se reputacioni dhe jeta private e individëve duhet të respektohen.

Në „Udhëzime për punë gazetareske“ nga Kodeksi i mediave⁸ në Gjermani, duke marr parasysh që cenimi i dinjitetit të njerëzve me paraqitje joedukate përmes fjalës dhe fotografisë është në kundërshtim me etikën gazetareske, gazetarët janë të detyruar ta respektojnë jetën private të individit dhe të drejtën e tij për vetëvendosje për informata personale, dhe ta garantojnë mbrotjen e të dhënave editoriale. Në rast të zbulimit të identitetit gjatë raportimit, interesi publik duhet

7 http://www.cmcc.org.cy/code_practice2.html. Data e qasjes: 19.4.2017.

8 http://www.presserat.de/fileadmin/user_upload/Downloads_Dateien/Pressekodex2017english.pdf. Data e qasjes: 1.4.2017.

t'i tejkalojë interesat për mbrojtjen e individëve në fjalë. Me këtë rast, interesi për sensibilizim si i tillë nuk e justifikon zbulimin e mundshëm të identitetit gjatë raportimit, pasi që, përderisa kërkohet anonimizim, ai duhet të jetë efikas.

Në të njëjtën gjë insiston edhe Këshilli flaman për etikë në Belgjikë, i cili, sipas Kodeksit⁹, e detyron gazetarin që ta respektojë dinjitetin njerëzor dhe të mos hulumtojë më shumë se sa lejon interesi publik, në lidhje me ndonjë temë apo çështje të caktuar. Gazetari duhet t'i shmangët shtrembërimin të imazheve dhe/ apo detajeve që duhet të publikohen, sidomos kur faktet ndikojnë fuqishëm në opinionin publik. Në këtë kontekst, ombudsmani për media në Suedi në Kodeksin e tij për etikë¹⁰ parashikon se është e nevojshme që me kujdes të mendohet për secilin publicitet që mund ta shkelë privatësinë e individëve, me ç'rast nevojitet përmbajtje nga publiciteti i tillë nëse interesi publik nuk e imponon atë.

Një hap më përpara në precizimin e situatave të mundshme në të cilat individit duhet të jetë i mbrojtur është edhe dispozita në „Parimet udhëheqëse për aktivitetet gazetareske“ në kuadër të Kodeksit për etikë për mediat austriake¹¹, ku në mënyrë eksplicite thuhet se raportimet e gazetarëve nuk do ta zbulojnë identitetin e individëve, jeta e të cilëve është në rrezik ndërsa me të mund të ekspozohen në rrezik edhe më të madh. Nga këtu edhe insistimi në „Udhëzimet për gazetarët“ i Këshillit për media në Finlandë¹² për të drejtën e privatësisë, të cilat duhet të aplikohen atëherë kur publikohen dokumente publike apo burime të tjera publike. Kapsshmëria publike e informacionit nuk implikon që ai duhet domosdo të publikohet. Diskrecioni është veçanërisht i rëndësishëm kur bëhet fjalë për çështjet që kanë të bëjnë me të miturit.

Në pjesën e mbrojtjes të privatësisë, si në dispozitat e analizuara të kodeksit qipriot etik, ashtu edhe në Udhëzimet e Kodeksit Etik të Kosovës¹³, thuhet se janë të papranueshme ndërhyrjet dhe hetimet në jetën private të individëve pa pajtimin e tyre, përfshirë këtu edhe fotografimin e njerëzve pa dijeninë apo pajtueshmërinë e tyre (përveç nëse ata nuk janë të involvuar në ngjarje që krijojnë lajme të interesit të përgjithshëm) apo pronës private, si dhe grumbullimin e informacioneve përmes mjeteve të përgjimit apo fotografimit prej së largu. Publikimi i tyre mund të justifikohet vetëm në disa raste të veçanta dhe vetëm në pajtim me interesin publik.

9 <http://www.rvdj.be/sites/default/files/pdf/code-rvdj.pdf>. Data e qasjes: 22.03.2017.

10 <http://www.po.se/regler/presstetiska-regler>. Data e qasjes: 03.04.2017.

11 http://www.presserat.at/rte/upload/pdfs/grundsaeetze_fuer_die_publicistische_arbeit_ehrenkodex_fuer_die_oesterreichische_presse_idf_vom_2.12.2013.pdf. Data e qasjes: 19.3.2017.

12 http://www.jsn.fi/journalistin_ohjeet/. Data e qasjes: 5.3.2017.

13 <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Udh%C3%ABzues-p%C3%ABr-Kodin-e-Mediave-t%C3%AB-Shkruara-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-mars2015.pdf>. Data e qasjes: 11.3.2017.

2. *Përgjigjet ndaj rasteve të raportimit diskriminues*

Në kohë kur ekzistojnë më shumë mundësi për keqpërdorim të punës së mediave në lidhje me lëshimin e informatave me të cilat nxitet diskriminimi, është e nevojshme që në praktikën gazetareske t'i kushtohet vëmendje e veçantë dëmit të shkaktuar nga diskriminimi i përhapur në baza të ndryshme. I udhëhequr nga kjo ide, Këshilli flaman për etikë në Belgjikë, në mënyrë eksplicite insiston që gazetari të mos guxojë të nxisë diskriminim apo racizëm. Gjatë raportimit, gazetari në tekstin e tij nuk do të stigmatizojë kur do t'i përmend faktorët siç janë përkatësia etnike, nacionaliteti, religjioni, ideologjia, orientimi seksual apo gjininë. Në këtë kontekst, dispozitat e analizuara nga Kodeksi qipriot potencojnë se mediati duhet t'i shmangen cilës do përmendjeje të drejtpërdrejt apo një veprimi tjetër kundër individit që përmban elemente paragjykimi në bazë të racës, ngjyrës, gjuhës, religjionit, bindjeve politike apo të tjera, kombësisë apo përkatësisë sociale, pronësisë, gjinisë, moshës apo statuseve të tjera individuale, përfshirë edhe sëmundjet psiqike dhe mentale apo aftësitë e kufizuara.

Dispozitat e këtilla decide për mbrojtjen e individit nga diskriminimi vërehen edhe në Kodeksin e Këshillit norvegjez për etikë¹⁴, i cili thotë se gjithmonë duhet të respektohet karakteri personal dhe identiteti, privatësia, përkatësia etnike, nacionaliteti dhe besimi, me çka do të duhet patur kujdes kur përdoren terme që krijojnë stigma dhe asnjëherë të mos tërhiqet vëmendja në aspektet personale dhe private nëse nuk janë relevante. Në këtë linjë të standardizimit është edhe Këshilli për media në Finlandë, ku, përveç se është shënuar dispozita për respektimin e dhinjitetit njerëzor të secilit individ, thuhet edhe se prejardhja etnike, nacionaliteti, gjinia, orientimi seksual, bindjet apo karakteristikat e tjera të njëjta personale, nuk guxon të prezantohen në mënyrë të papërshtatshme apo përçmuese.

Një dispozitë e këtillë ekziston edhe në „Parimet udhëheqëse për aktivitetet gazetareske“ në Kodeksin e mediave në Austri, ku theksohet se çdo diskriminim për shkak të moshës, aftësive të kufizuara, gjinisë, nacionalitetit, seksualitetit, ideologjisë apo për çfarëdo arsye, është i papranueshëm, me çka deklaratat diskriminuese me të cilat përçmohet apo nxitet dyshim kundër një individ apo një grupi duhet shmangur në mënyrë rigorozë. Mu për këtë në Udhëzimet e Këshillit për etikë në Holandë¹⁵ precizohet se në raportime do të konstatohen përkatësia etnike, nacionaliteti, raca, religjioni dhe përkatësia seksuale e grupeve dhe individëve vetëm nëse ajo është e domosdoshme për të kuptuar drejtë faktet dhe rrethanat për të cilat raportohet.

14 <http://presse.no/pfu/etiske-regler/vaer-varsom-plakaten/>. Data e qasjes: 08.04.2017.

15 <https://www.rvdj.nl/leidraad>. Data e qasjes: 3.4.2017.

3. *Mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve gjatë raportimit*

Normat e përpunuara në mënyrë më precize për këtë çështje komplekse dhe sensitive në pjesën e raportimit etik dhe të përgjegjshëm të mediave dhe gazetarëve, janë dhënë në „Udhëzimet për punën gazetareske“ në Kodeksin gjerman për etikë, ku insistohet në kujdes të skajshëm gjatë publikimit të identitetit të fëmijëve dhe të miturve para se ti mbushin 18 vjet, kur bëhet fjalë për raportimet mbi krimet dhe fatkeqësitë. Për më tepër, në kapitullin që ka të bëjë me raportimin sensacional dhe mbrojtjen e të rinjve, në mënyrë precize thuhet se gazetarët do të përmbahen nga të paraqiturit e papërshtatshëm sensacional të dhunës, brutalitetit dhe vuajtjes dhe do ta respektojnë mbrojtjen e të rinjve, gjegjësisht gjatë paraqitjeve me fotografi të akteve të dhunës dhe fatkeqësive në faqen kryesore, gazetarët do t'i respektojnë efektet e mundshme ndaj fëmijëve dhe të miturve.

Për më tepër, në Kodeksin e Norvegjisë kërkohet që gjatë raportimit paraprakisht të vlerësohen implikimet që mediat mund t'i shkaktojnë në çfarëdo rasti, duke e theksuar rregullin e përgjithshëm se identiteti i fëmijëve nuk duhet të shpalojë as gjatë raportimit në lidhje me kontestet familjare apo rastet që shqyrtohen nga shërbimet sociale për përkujdesje ose nga gjykatat. Kjo, gjithashtu vlen edhe për rastet kur personi përgjegjës apo prindi japin pajtueshmëri për zbulimin e identitetit të fëmijëve dhe/apo të të miturve.

Edhe në udhëzimet e kodeksit etik të Këshillit të Kosovës theksohet obligueshmëria e mediave për të vepruar në përputhje me Konventën për të drejtat e fëmijëve të KB-së. Së paku në tre dispozita vërtetohet se mediat duhet patur leje nga prindërit apo kujdestarët për intervistë, video incizim apo fotografim të fëmijëve nën 16 vjet. Gjithashtu, mediat nuk duhet ta identifikojnë fëmijën nën 16 vjet, përveç nëse ai nuk është i involvuar në veprime kriminale, si dëshmitar apo si i pandehur. Ndryshe, gazetarët nuk guxojnë t'i intervistojnë, t'i shqetësojnë, t'i fotografojnë apo t'i incizojnë fëmijët në shkollë apo në afërsi të shkollës pa lejen e drejtorit të shkollës.

Dispozita identike ka edhe në Kodeksin austriak, i cili thotë se në raste që kanë të bëjnë me identitetin e fëmijëve, mbrojtja e tyre do të ketë përparësi në krahasim me vlerën e informacioneve. Para se të publikohen fotografi dhe raporte mbi të miturit, kujdes të veçantë kritik do t'i kushtohet çështjes nëse publikimi i tillë është me interes publik. Sidomos në kushte kur gjithnjë e më tepër besohet se raportimet për krime dhe shkelje të kryera nga persona të mitur, mund të shkaktojnë vështirësi në një fazë të mëvonshme apo tërësisht ta pengojnë integrimin e tyre të sërishëm në shoqëri. Mu për këtë edhe justifikohet tendenca që të mos publikohet emri i plotë i individit, gjegjësisht, siç thuhet në nenin e fundit të këtij Kodeksi, gazetarët do të praktikojnë kujdes të veçantë gjatë intervistimit dhe fotografimit të fëmijëve dhe raportimit mbi çështje që mund të jenë të dëmshme për ardhmërinë e tyre.

4. Raportimi për krim

Në kryerjen e përditshme të detyrave që dalin nga angazhimi profesional i gazetarëve dhe mediave, në kushte të mundësive më të mëdha për sensacion, gazetarët dhe mediat po përballen gjithnjë e më shumë me një çështje edhe më të vështirë dhe të përgjegjshme që duhet në veçanti të shqyrtohet nga objektivi moral, gjegjësisht me nevojën për raportim të përgjegjshëm dhe etik mbi krimin, veprat penale, kryerësit e tyre, viktimat por edhe të afërmit e tyre.

Pikërisht, në Kodeksin në Gjermani është deklaruar qartë se opinioni ka interes legjitim për tu informuar në lidhje me veprat penale, procedurat, hetimet dhe proceset gjyqësore dhe se është punë e gazetarëve për të raportuar rreth këtyre çështjeve, me çka në veçanti duhet të shqyrtohen faktorët në vijim: intensiteti i dyshimit, serioziteti i akuzave, gjendja e procedimeve, shkalla e famës së të dyshuarit apo të kundërvajtësit, sjellja e tyre në të kaluarën, etj. Rjedhimisht, gazetarët do t'i publikojnë vetëm emrat, fotografitë dhe informatat e tjera që mundësojnë zbulim të identitetit të të dyshuarve apo të kundërvajtësve nëse interesi legjitim i publikut mbizotëron interesat për mbrojtjen e identitetit të personave të përfshirë në secilin prej rasteve. Por, publikimi i emrave dhe fotografive të dëshmitarëve në përgjithësi është i papranueshëm. Në rast të raportimit të përditësuar për procedurë penale të së kaluarës, si rregull, nuk do të publikohet emri apo fotografia e kundërvajtësit në interes të risocializimit, pasi që interesi për risocializim është më i madh nëse periudha që ka kaluar nga ndëshkimi është më e gjatë.

Më tutje, ky Kodeks përcakton normën se edhe në raportimin mbi akte reale dhe kërcënuese duhet që të raportohet për incidente të këtilla në mënyrë të pavarur dhe autentike, përmes të cilit gazetari nuk do të lejojë që të bëjë veten e tij „vegël për kriminelët“, që do të thotë se nuk do të bëjë përpjekje për ndërmjetësim mes kriminelëve dhe policisë dhe nuk do të bëjë intervista me kundërvajtësit gjatë kryerjes së akteve të dhunës. Në këtë kontekst, Këshilli për etikë në Finlandë shkon një hap përpara kur përcakton normat që gjatë kohës kur vijon gjykimi, gazetari nuk do të tentojë të ndikojë në vendimin e gjykatës apo paraprakisht të prezantojë gjendje të fajit të subjektit në fjalë.

Në të njëjtën kohë, gjatë shqyrtimit të çështjes për krime, në veçanti duhet të trajtohet edhe pyetja për standardizimin e raportimit gazetaresk në raport me viktimat e atij krimi dhe të afërmeve të tyre. Ashtu siç kërkon Kodeksi suedez, gjithmonë duhet të tregohet sa më shumë mirëkuptim për viktimat e krimit dhe fatkeqësive lidhur me atë se duhet të publikohet emri dhe fotografitë e viktimave dhe të familjarëve të tyre. Në vijim, në përpuethshmëri me Kodeksin finlandez, viktimat e krimit nga dëmtime të ndryshme apo fatkeqësi, kanë të drejtë ta ruajnë identitetin e tyre, përveç në raste kur për shkaqe të mirëkuptimit më të mirë të ngjarjes, nevojitet zbulimi i identitetit para opinionit.

Dispozita edhe më precize hasim në Kodeksin gjerman, ku, mes tjerash, në pjesën e mbrojtjes së viktimave thuhet se zbulimi i identitetit të viktimës zakonisht është irelevant për ta kuptuar fenomenin e fatkeqësisë, rrethanat e fatkeqësisë apo krimin, me ç'rast publikimi i emrit dhe fotografisë së viktimës është i lejuar nëse falmijarët e tyre apo individë të tjerë të autorizuar kanë dhënë pajtueshmëri, ose nëse viktima është person publik. Në raste kur bëhet fjalë për familjarë dhe persona të tjerë që janë në mënyrë indirekte të prekur nga publikimi dhe nuk kanë asnjë lidhje me lëndën aktuale për të cilën raportohet, zakonisht nuk lejhet publikimi i emrave dhe fotografive.

Në fakt, ashtu siç thuhet në Kodeksin norvegjez, gjithmonë duhet menduar për mënyrën se si raportimi rreth fatkeqësisë dhe krimin mund të ndikojë tek viktimat dhe të afërmit e tyre. Duhet të tregohet mirëkuptim për njerëzit në zi apo gjatë kohës kur ata përjetojnë një shok, dhe, për këtë asye nuk lejohet zbulimi i identitetit të viktimave apo të njerëzve të zhdukur deri atëherë kur të njoftohen të afërmit e tyre.

5. Raportime për vetëvrasje

Kur flitet për përgjegjësinë dhe etikën gjatë raportimit të gazetarëve në lidhje me vetëvrasjet „ekzistojnë shumë keqkuptime dhe perceptime të gabuara rreth problemit me vetëvrasjet, ndërsa mediat mund të luajnë rol tejet të rëndësishëm (...) Për to nuk duhet të raportohet në mënyrë të thjeshtësuar. Përkundrazi, mediat duhet t'i shqyrtojnë të gjithë faktorët e ndryshëm, mes të cilëve edhe ata kulturor, gjenetik dhe sociokulturor (...), për ta edukuar opinionin për këtë problem shoqëror, e në veçanti ata që ballafaqohen me rrezik të sjelljes së tillë, të kërkojnë ndihmë përkatëse”¹⁶.

Të udhëhequr nga roli i këtillë i mediave, në një nga kodeksët më preciz – ai gjerman, thuhet se në raportimin mbi vetëvrasje nevojitet vetëpërmbytje. Kjo vlen veçanërisht gjatë publikimit të emrave dhe fotografive, si dhe të përshkrimit të rrethanave të veçanta në të cilat ka ndodhur vetëvrasja. Aq më tepër, Kodeksi norvegjez, kërkon kujdes gjatë raportimit, gjegjësisht shmangjen e përshkrimit të metodave apo punëve të tjera që mund të kontribuojnë në provokimin e vetëvrasjeve të ardhshme, e në përputhje me nevojën e përgjithshme për informacione, në qoftë se nuk ka nevojë, aspak të mos raportohet për të ¹⁷.

Në të njëjtën kohë, sipas konkludimeve të kësaj analize, është evidente

16 Marina Tuneva & Filjana Koka, *Етичко извествување на медиумите во Европа и Македонија*. SHGM & Konrad Adenauer, Shkup, 2016, faq. 39-40.

17 Sipas të dhënave të OBSH, në nivel vjetor vetëvriten pothuajse një milion persona, ndërsa vlerësohet se nga kjo mesatarisht janë të prekur më së paku 6 persona. World Health Organization (2008) Preventing Suicide – A Resource for Media Professionals, 2008. [http://www.who.int/mental_health/prevention/suicide/resource_ media.pdf](http://www.who.int/mental_health/prevention/suicide/resource_media.pdf). Data e qasjes: 11.11.2016.

se në Kodin suedez për etikë të ombudsmanit për media bëhet edhe plotësimi i normës dhe ajo përfshin jo vetëm vetëvrasjen, por edhe tentimin për vetëvrasje, duke insistuar në kujdes më të madh në publikimin e informacioneve, në veçanti të atyre që kanë të bëjnë me ndjenjat e familjarëve, por edhe në lidhje me privatësinë e viktimës.

Në këtë insiston edhe Këshilli flaman për etikë, ku kërkohet që të evitohet dramatizimi, detajet e ekzagjuruara si dhe prezantimi pozitiv i fakteve, me çka insistohet në „evitim të fjalorit me të cilin vetëvrasja bëhet sensacion apo normalizohet, ose prezantohet si zgjidhje e problemeve“¹⁸.

III. PËRFUNDIM

Vetë-rregullimi është më se i nevojshëm „për ndërtimin e besimit dhe kredibilitetit në media; për përmirësimin e stanardeve për cilësi në media, për parandalimin e ndërhyrjes së shtetit dhe organeve shtetërore; dhe për zvogëlimin e numrit të rasteve gjyqësore kundër gazetarëve (...)“¹⁹. Mu për këtë është edhe ky shqyrtim: që të ofrojë një pasqyrim të temave dhe dilemave, si dhe praktikave të mira dhe zgjidhjeve të mundshme nga përvoja e anëtarëve të Aleancës për këshilla të pavarur për etikë në media në Evropë (AIPCE), para së gjithash ata që kanë tradita shumëvjeçare sa u përket çështjeve dhe sfidave me vetë-rregullimin.

Në fakt, në kohëra të përdorimit gjithnjë e më të shpeshë të internetit si platformë për shkëmbimin e informacioneve, gjithnjë e më e madhe është nevoja për rikonsiderimin e atij shkëmbimi, në vendin dhe rolin e gazetarisë, të gazetarit..., në tërësi, realiteti mediatik, në veçanti në pjesën e kufirit të mundshëm mes etikes dhe ligjores gjatë paraqitjes së ankësive dhe vendimeve të sjellura nga ana e këshillave për materiale dhe shërbime onlajn, më pas rregullimi i mundshëm i blogjeve, marrja dhe tansmetimi i informacioneve përmes rrjeteve sociale, e deri në të drejtën themelore të njeriut në këtë fushë - mbrojtja e privatësisë. Bëhet fjalë për zgjedhje aplikative të cilat njëkohësisht mund të japin përgjigje për sfidat aktuale në të cilat haset kur kemi të bëjmë me raportimin mediatik mbi çështje sensitive me interes publik edhe te ne.

Qëllimi është që të prezantohen përvojat që janë të dobishme, jo vetëm për Këshillin, por, edhe për ekspertët dhe opinionin më të gjërë, dhe me këtë do të ndihmonin edhe gjatë plotësimit eventual të kornizës etike në Republikën e Maqedonisë kur bëhet fjalë për këto tema. Përmes hapjes së diskutimeve lidhur me atë që ofrohet, mund të ndikohet në lidhje me „përmirësimin“ e pasqyrës së

18 Marina Tuneva & Filjana Koka, *Етичко известување на медиумите во Европа и Македонија*. SHGM & Konrad Adenauer, Shkup, 2016, faq. 40.

19 Ognjan Zlatev, „Këshilli për etikë“, në *Udhëzuesin për vetë-regullim të medimeve*, Miklosh Harashti dhe të tjerë, Këshilli për etikë në media në Maqedoni, Shkup, 2016, faq. 45-46.

gazetarisë të Maqedonisë. Nga këtu, shpresojmë se analiza do të shërbejë si një pikë referimi për të nxitur hulumtime të mëtejshme në fusha më specifike, me çka do të thjeshtësohej dhe do të lehtësohej procesi i zgjidhjes së dilemave konkrete.

IV. LITERATURA E PËRDORUR

1. Bertrand, Claude-Jean. *Media deontologjike*. Zagreb: Libraria e Univeristeti & JETiC, 2007.
2. Donev, Dejan. *Етика во новинарството*. Shkup: UKIM, 2011.
3. Karklinš, Janis. „Uvodnik“, во *Profesionalno novinarstvo & Samoregulacija*, Stjepan Malović (ur.), UNESCO, Zagreb, 2001.
4. Milošević, Milan. *Ethics and Journalism in the South Eastern Europe: Comparative analysis of the journalistic profession*. Belgrade: Media Center, 2005.
5. Tuneva Marina & Filjana Koka. *Етичко известување на медиумите во Европа и Македонија*. Shkup: SHGM & Konrad Adenauer, 2016.
6. Zllatev, Ognjan. „Këshilli për etikë“, në *Водич за саморегулација во медиумите*, Miklosh Harashtini dhe të tjerë. Shkup: Këshilli për etikë në mediat në Maqedoni, 2016.
7. Villoviç, Gordana. „Etičnost masovnog komuniciranja“, në *Komunikimin masiv*, Stjepan Malović et al. (ur.). Zagreb: Golden marketing-Tehnička knjiga, Sveučilište Sjever, 2014.

Burime-interneti:

1. World Health Organization (2008) Preventing Suicide – A Resource for Media Professionals, 2008. http://www.who.int/mental_health/prevention/suicide/resource_media.pdf. Data e qasjes: 11.11.2016.
2. http://www.cmcc.org.cy/code_practice2.html. Data e qasjes: 19.4.2017.
3. http://www.presserat.de/fileadmin/user_upload/Downloads_Dateien/Pressekodex2017english.pdf. Data e qasjes: 1.4.2017.
4. <http://www.rvdj.be/sites/default/files/pdf/code-rvdj.pdf>. Data e qasjes: 22.3.2017.

5. <http://www.po.se/regler/pressetiska-regler>. Data e qasjes: 3.4.2017.
6. http://www.presserat.at/rte/upload/pdfs/grundsaeetze_fuer_die_publizistische_arbeit_ehrenkodex_fuer_die_oesterreichische_presse_idf_vom_02.12.2013.pdf. Data e qasjes: 19.3.2017.
7. http://www.jsn.fi/journalistin_ohjeet/. Data e qasjes: 5.3.2017.
8. <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Udh%C3%ABzues-p%C3%ABr-Kodin-e-Mediave-t%C3%AB-Shkruara-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-mars2015.pdf>. Data e qasjes: 11.3.2017.
9. <http://presse.no/pfu/etiske-regler/vaer-varsom-plakaten/>. Датум на пристап: 08.04.2017.
10. <https://www.rvdj.nl/leidraad>. Data e qasjes: 3.4.2017.